

Konform nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, nenit 12 alineja 1, nenit 17 alineja 1 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nenit 25 alineja 4 pika (b) dhe të nenit 27 alineja 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2009, mori këtë

## **V E N D I M**

### **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË PLANIT DETAL URBANISTIK TË LAGJES "JAGLENICA" NË PRIZREN**

#### Neni 1

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit të Planit Detal Urbanistik (PDU-së) të lagjes ish-Jaglenica e tani "Dardania" në Prizren, nr. 01/011-72 të dt. 01.06.1983, e shpallur në Fl.zyrtare të KSAK nr. 27/83..

#### Neni 2

Ndryshimi dhe plotësimi i PDU-së, bëhet në këtë mënyrë: "Në pjesën grafike të elaboratit teknik në ngastrat kadastrale nr. 1958; 1959; 1960; 1953; 1954 dhe 1962 në sip. të përgjithshme prej 70 ari, në vend të gjelbërimit ekzistues e paraparë me PDU-në, parashihet ndërtimi i lartë i objekteve të destinuar për familjet e dëshmorëve dhe për rastet sociale", me etazhitet maksimal P+4.

#### Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është paraqitja grafike si dhe ekstrakti nga Planit Detal Urbanistik i lagjes "Jaglenica" në përputhshmëri me këtë Vendim.

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës dhe Drejtoria e Administratës-Spektori për Çështje Pronëso-ro-Juridike.

#### Neni 5


Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në "Kumtar".

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**

**Nr. 01/011-3257**

**Më 30 prill 2009**

Prizren



Kryesuesi i Kuvendit  
Nijazi Kryeziu